

**VENDIM**  
**Nr. 632, datë 27.10.2021**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV, LAÇ 2 – URA E MATIT-SKURAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV, Laç 2 – Ura e Matit-Skuraj”.
  2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 190 736 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.
  4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 190 736 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
  5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
  6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
  7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
  8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
  9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
  10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Kurbin, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., fillon procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
  11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
  12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Lezhë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtar.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 kV SKURAJ – URA MATIT – NST/LAC 2

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë arë

| Nr.                                                           | Emri            | Atësia | Mbiemri   | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. e pronës që shpronësohet m² | Vlera e shpronësimit në lek/² | Vlera e shpronësimit, lek/shtyllë |
|---------------------------------------------------------------|-----------------|--------|-----------|-----------------|----------------|------------------|----------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------|
| BASHKIA KURBIN                                                |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| FSHATI SHULLAZ                                                |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| 1                                                             | Shtet           |        |           | 3441            | 116/3          | Arë              | 158.5                            |                               |                                   |
| 2                                                             | Shtet           |        |           | 3441            | 122/3          | Arë              | 207                              |                               |                                   |
| 3                                                             | Shtet           |        |           | 3441            | 127/11         | Arë              | 182                              |                               |                                   |
| 4                                                             | Hamit           | Kasem  | Lama      | 3441            | 127/6          | Arë              | 158.5                            | 278                           | 44,063                            |
| 5                                                             | BKT sh.a.       |        |           | 3441            | 129/11         | Arë              | 182                              | 278                           | 50,596                            |
| 6                                                             | Shtet           |        |           |                 |                | K-34-88-(7-B)    | 111.1                            |                               |                                   |
| 7                                                             | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 49       | 111.1                            |                               |                                   |
| 8                                                             | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 49       | 92                               |                               |                                   |
| 9                                                             | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 48/c     | 49.4                             |                               |                                   |
| 10                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 47/b     | 92                               |                               |                                   |
| 11                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 46/a     | 49.4                             |                               |                                   |
| 12                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 46/a     | 158.5                            |                               |                                   |
| 13                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 44/a     | 111.1                            |                               |                                   |
| 14                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 37       | 158.5                            |                               |                                   |
| 15                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 36/a     | 207                              |                               |                                   |
| 16                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 36/a     | 64.8                             |                               |                                   |
| 17                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 36/a     | 111.1                            |                               |                                   |
| 18                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 35/b     | 111.1                            |                               |                                   |
| 19                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 30/a     | 92                               |                               |                                   |
| 20                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 30/a     | 76                               |                               |                                   |
| 21                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 30/a     | 92                               |                               |                                   |
| 22                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 30/a     | 161.3                            |                               |                                   |
| 23                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 28/a     | 158.5                            |                               |                                   |
| 24                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Troje fshati     | 182                              |                               |                                   |
| 25                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 31       | 17.8                             |                               |                                   |
| 26                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 32       | 17.8                             |                               |                                   |
| 27                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 32       | 17.8                             |                               |                                   |
| 28                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Lumi Mat         | 56.7                             |                               |                                   |
| BASHKIA LEZHË                                                 |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| FSHATI ZEJMEN                                                 |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| 29                                                            | Shtet           |        |           |                 |                | Ngastra 127/a    | 17.8                             |                               |                                   |
| 30                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | 590              | 111.1                            |                               |                                   |
| 31                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | Ngastra 128/b    | 158.5                            |                               |                                   |
| 32                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | Ngastra 151      | 180.1                            |                               |                                   |
| 33                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | Ngastra 151      | 64.8                             |                               |                                   |
| 34                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | Ngastra 151      | 49.4                             |                               |                                   |
| 35                                                            | Shtet           |        |           | 1168            |                | Ngastra 151      | 76                               |                               |                                   |
| 36                                                            | Shtet(Lumi Mat) |        |           |                 |                | Lumi Mat         | 111.1                            |                               |                                   |
| BASHKIA KURBIN                                                |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| FSHATI FERR SHKOPET                                           |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               |                                   |
| 37                                                            | Shtet           |        |           | 3470            | 10/26          | Arë              | 111.1                            |                               |                                   |
| 38                                                            | Shtet           |        |           | 3470            | 10/26          | Arë              | 111.1                            |                               |                                   |
| 39                                                            | Shtet           |        |           | 3470            | 10/31          | Arë              | 111.1                            |                               |                                   |
| 40                                                            | Vlash           | Ndue   | Perndreka | 3470            | 29             | Arë              | 111.1                            | 278                           | 30,886                            |
| 41                                                            | Llesh           | Preng  | Hyseni    | 3470            | 5              | Arë              | 76                               | 278                           | 21,128                            |
| 42                                                            | Pro Credit Bank |        |           | 3470            | 22             | Arë              | 158.5                            | 278                           | 44,063                            |
| Sipërfaqe totale shpronësimi m²                               |                 |        |           |                 |                |                  | 686.10                           |                               |                                   |
| Vlera totale e shpronësimit në lek për sipërfaqet e pronësisë |                 |        |           |                 |                |                  |                                  |                               | 190,736                           |